



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
RAJONAL





KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE

# NISMAT LOKALE DHE RAJONALE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

-Potenciali lokal, donatorët dhe investitorët-

## PLANI I SHTRIRJES DHE KOMUNIKIMIT



# 1

## SHTYLLA 1: ORGANIZIMI I KOMPONENTËS KOMUNALE PËR PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Kjo shtyllë përqendrohet në organizimin e strukturave komunale për planifikim strategjik dhe zhvillim ekonomik, duke përfshirë analizën e potencialit lokal, rritjen e kapaciteteve dhe adaptimin e modeleve të suksesshme.

- Skanimi i potencialit lokal  
Përcaktimi i profileve të komunës (ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor) përmes analizave të të dhënave të brendshme dhe burimeve të jashtme. Hartimi i një Raporti të Detajuar të Potencialit Zhvillimor që përfshin: Potencialin për agrobiznes, turizëm, prodhim, shërbime, industri të lehta  
Potencialin e fuqisë punëtore, veçanërisht të të rinjve dhe grave  
Infrastruktura e disponueshme dhe hapësirat për zhvillim
- Analizimi i dokumenteve ekzistuese  
Plane Zhvillimore Komunale (PZHK) 3 vlerësimi i përputhshmërisë me prioritetet zhvillimore.  
Strategjitë Lokale të Zhvillimit Ekonomik dhe planet sektoriale (arsim, bujqësi, turizëm, TIK). Planet e Mobilitetit Urban dhe Planifikimi i Hapësirës Urbane.
- Përdorimi i të dhënave të sistemuara  
Të dhëna nga: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) MINT (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë) Agjencia për Punësim  
Dhomat Ekonomike dhe Shoqatat e Bizneseve  
Krijimi i një dashboardi të indikatorëve zhvillimorë komunalë për vendimmarrje strategjike.

## 1.1. ANALIZA E POTENCIALIT DHE NJOHJA ME DOKUMENTET STRATEGJIKE

### **Evidenca e potencialit lokal**

Përcaktimi i profileve të komunës (ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor) përmes analizave të të dhënave të brendshme dhe burimeve të jashtme.

Hartimi i një Raporti të Detajuar të Potencialit Zhvillimor që përfshin:

- Potencialin për agrobiznes, turizëm, prodhim, shërbime, industri të lehta
- Potencialin e fuqisë punëtore, veçanërisht të të rinjve dhe grave
- Infrastruktura e disponueshme dhe hapësirat për zhvillim

### **Analizimi i dokumenteve ekzistuese**

Plane Zhvillimore Komunale (PZHK) - vlerësimi i përputhshmërisë me prioritetet zhvillimore.

Strategjitë Lokale të Zhvillimit Ekonomik dhe planet sektoriale (arsim, bujqësi, turizëm, TIK).

Planet e Mobilitetit Urban dhe Planifikimi i Hapësirës Urbane.

### **Përdorimi i të dhënave të sistemuara**

Të dhëna nga:

- ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës)
- MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal)
- MINT (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë)
- Agjencia për Punësim
- Odat Ekonomike dhe Shoqatat e Bizneseve

Krijimi i një dashboardi të indikatorëve zhvillimorë komunalë për vendimmarrje strategjike.

## 1.2. RRTIJA E KAPACITETEVE PËR HARTIM TË PROJEKTEVE ZHVILLIMORE



### Trajnime për zyrtarët komunalë

Modulet e trajnimit përfshijnë:

- Logjika e ndërhyrjes dhe korniza logjike e projekteve
- Teoria e Ndryshimit
- Matja e ndikimit dhe indikatorët SMART
- Përgatitja e projekt-propozimeve për fonde nga BE, IPA, donatorë të huaj, nivelin qendror
- Hartimi i buxheteve zhvillimore dhe analizës kosto-përfitim

### Hartimi i Planeve të Veprimit për Investime



- Për çdo projekt prioritar të identifikuar, të hartohet një plan i veprimit me afate dhe kosto.
- Krijimi i një portofoli zhvillimor për promovim të investitorët dhe donatorët.



### Krijimi i njësive të përhershme për planifikim strategjik

Funksionalizimi i një Njësie për Planifikim dhe Koordinim Strategjik me këtë përbërje:

- Koordinator i planifikimit strategjik
- Ekspert i zhvillimit ekonomik lokal
- Ekspert i monitorimit dhe matjes së rezultateve

Vendosja e mekanizmave të brendshëm për bashkërendim ndër-drejtorial.

Veprim	Përkthimi	Afati	Aktorët
<b>Haritimi i Udhëzuesit Komunal për Planifikim Strategjik</b>	Përmban metodologjinë, formatet dhe udhëzimet për hartimin e projekteve dhe planeve të zhvillimit	3 muaj	Komuna, MAPL, donatorë
<b>Realizimi i Forumit Komunal për Zhvillim</b>	Platformë vjetore për diskutim publik mbi prioritetet zhvillimore	Viti 1	Komuna, bizneset, OSHC-të
<b>Krijimi i Regjistrit të Projekteve</b>	Platformë digjitale për projektet zhvillimore në faza të ndryshme	6 muaj	Njësia për Planifikim Strategjik
<b>Platformë për Konsultim të Hapur</b>	Kalendar publik i konsultimeve me sektorin privat, OSHC dhe qytetarët për çdo projekt	Në vazhdim	Zyra për Investime dhe Partneritete

## 2

## SHTYLLA 2: DIALOGU BRENDA, NDËR-KOMUNAL DHE NDER-INSTITUCIONAL

### 2.1. KONSULTIMI ME DIKASTERET KOMUNALE DHE GRUPET E INTERESIT

#### ■ MBLEDHJE TË RREGULLTA NDËR-DREJTORALE.

Mbajtja e takimeve mujore të koordinimit midis drejtorive të komunës (Zhvillim Ekonomik, Urbanizëm, Financa, Bujqësi, Arsimit, Kulturë, etj.) për:

- Harmonizimin e prioriteteve dhe projekteve zhvillimore
- Ndërveprim efektiv për planifikim buxhetor dhe mobilizim resurcesh
- Vlerësimin e progresit dhe eliminimin e duplikimeve të punës

#### ■ PËRFSHIRJA E GRUPEVE TË INTERESIT NË VENDIMMARRJE

Formimi i Këshillit Konsultativ për Zhvillim Lokal, me përfaqësues nga: OSHC-të dhe grupet avokuese (barazi gjinore, të rinjtë, PAK, mjedisi)

- Shoqatat e bizneseve dhe odat ekonomike
- Kooperativat e fermerëve dhe përfaqësues të sektorit rural
- Ekspertë të fushave dhe profesionistë të komunitetit

#### ■ ORGANIZIMI I TAKIMEVE TË HAPURA PUBLIKE PËR DISKUTIM TË PROJEKTEVE DHE PRIORITETEVE.

Përdorimi i mjeteve si:

- Pyetësorë online
- Platforma konsultative komunale
- ryeza tematike dhe fokus grupe
- Fletëpalosje për komunitetin mbi projektet e ardhshme



## 2.2.DIALOGU NDËR-KOMUNAL

### FORUMET E PËRBASHKËTA

Organizimi i Forumeve të Rajonit  
Zhvillimor për projekte me interes të  
ndërsjellë, ku marrin pjesë komuna fqinje  
për të identifikuar:


- Pikat e përbashkëta për investime  
infrastrukturore (rrugë, ujësjellës,  
impiante)
- Zona të përbashkëta për zhvillim  
rural, turistik dhe agro-industrial
- Ndërveprim për mbrojtje të mjedisit  
dhe menaxhim të mbetjeve të ngurta

### MEMORANDUME BASHKËPUNIMI (MOU)

- Menaxhimin e përbashkët të  
impianteve të ujërave të zeza
- Ndërtimin dhe menaxhimin e zonave  
ekonomike ndërkomunale
- Zhvillimin e rrjetit të përbashkët të  
transportit publik ndërkomunal
- Partneritete për projekte të  
përbashkëta në programet e IPA-së  
dhe BE-së

---

### HARTA NDËRKOMUNALE E PROJEKTEVE

- Krijimi i një harte të përbashkët digjitale ku pasqyrohen projektet e  
rëndësisë rajonale
  - Vendosja e mekanizmave për koordinim dhe ndarje të kostove dhe  
përfitimeve
- 

## 2.3. DIALOGU ME NIVELIN QENDROR

### **PREZANTIMI STRATEGJIK I PROJEKTEVE TË GATSHME**

- Hartimi i dokumentacionit të plotë të projektit (DAP) për prezantim:
  - MAPL – për validim ligjor dhe prioritizim në grantet qeveritare
  - MINT – për partneritet me investitorët dhe përfshirje në agjendat industriale
  - MZHR – për bashkërendim me prioritetet zhvillimore kombëtare dhe rajonale

### **PËRDORIMI I PLATFORMAVE KOMBËTARE DHE FONDEVE IPA III**

- Aplikimi në Platformën për Investime Strategjike të Qeverisë së Kosovës
- Shfrytëzimi i mundësive nga Programi IPA III për:
  - Projekte infrastrukturore, energji të gjelbër, ekonomi digjitale
  - Ngritjen e kapaciteteve administrative dhe reformave territoriale

### **NDËRMJETËSIM POLITIK PËR MBËSHTETJE INSTITUCIONALE**

- Përdorimi i takimeve me deputetë, ministri, ambasada dhe delegacionin e BE-së për avokim
- Organizimi i Eventeve Prezantuese ("Invest in Our Municipality", "Dita e Projektit Strategjik") për të promovuar projektet para vendimmarrësve të nivelit qendror



Veprim	Përshkrimi	Afati	Aktorët
<b>Krijimi i “Forumit të Partneritetit Lokal”</b>	Tipezë e përhershme për dialog të strukturuar me aktorët lokalë dhe rajonalë	6 muaj	Komuna, OSHC, Bizneset
<b>Nënshkrimi i MoU-ve me komunat fqinje</b>	Për projektet prioritare ndërkomunale në fushën e mjedisit dhe infrastrukturës	12 muaj	Komunat përkatëse
<b>Kalendar Vjetor i Konsultimeve</b>	Agjendë publike e takimeve me dikasteret dhe grupet e interesit	Viti 1	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
<b>Zhvillimi i një portali për ndërveprim institucional</b>	Platformë digjitale për komunikim dhe ndarje dokumentesh me nivelin qendror dhe komuna të tjera	9 muaj	Komuna, MAP, MINT

# 3

## SHTYLLA 3: PËRGATITJA E AGJENDAVE DHE KALENDARËVE KOMUNALE

### 3.1. TAKIMET PERIODIKE ME PALËT E INTERESIT

#### **KALENDAR I RREGULLT I TAKIMEVE MUJORE**

- Hartimi dhe publikimi i kalendarit vjetor të konsultimeve publike me:
  - OSHC-të që operojnë në komunë dhe në rajon
  - Shoqatat e sektorit privat, përfshirë biznese, zejtarë, prodhues dhe ofrues shërbimesh
  - Rrjetin e ekspertëve vendorë dhe profesionistëve për analizë sektoriale
- Kalendar i aksesueshëm online në uebfaqen e komunës dhe në rrjetet sociale zyrtare.

#### **TAKIME TË VEÇANTA PËR KOMUNITETET ME INTERES TË VEÇANTË:**

- Mbledhje tremujore me:
  - Diasporën, për të diskutuar investimet në komunë dhe lidhjen me zhvillimin lokal
  - Gratë sipërmarrëse, për identifikimin e nevojave për mbështetje dhe rrjetëzim
  - Grupet e të rinjve, për ide të reja dhe ndërmarrësi sociale
  - Personat me aftësi të kufizuar, për ndërtimin e projekteve gjithëpërfshirëse

#### **PËRDORIMI I METODAVE MODERNE TË ANGAZHIMIT:**

- Platforma digjitale për komente dhe ide
- "Kutitë e ideve" në qendrat e komunitetit
- Takime online për përfshirje më të gjerë



## 3.2. NGJARJET TEMATIKE ME PËRFSHIRJE RAJONALE


### FORUMET PËR SEKTORË STRATEGJIK

Organizimi i forumeve zhvillimore në partneritet me komunat fqinje dhe organizata kombëtare për:

- Bujqësi: zinxhirët e vlerës dhe tregjet lokale
- TIK: qendrat e inovacionit, edukimi digjital dhe start-up
- Turizëm: hartimi i paketave të përbashkëta, promovimi i destinacioneve natyrore
- Energjia e ripërtëritshme: projekte për eficiencë energjetike dhe përdorim të burimeve të qëndrueshme

### VIZITA TË NDËRSJELLA

Realizimi i vizitave studimore me komuna të tjera për:

- Shkëmbim të përvojave për planifikim strategjik dhe menaxhim të fondeve
  - Ndarje të praktikave për përfshirje qytetare dhe digjitalizim të shërbimeve
  - Promovim të përbashkët të iniciativave zhvillimore
- 

### 3.3. TAKIME ME INSTITUCIONE QENDRORE, DONATORË DHE INVESTITORË



#### **VIZITA PUNE NË NIVEL QENDROR**

- Hartimi i agjendave tremujore të takimeve me:
  - Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR)
  - Ministrinë e Ekonomisë, Infrastrukturës, MAPL dhe MINT
  - Zyrat e IPA dhe zyrtarët e projekteve ndërkombëtare
- Qëllimi: harmonizim i dokumenteve, listës së projekteve dhe qasje më e mirë në financime.

#### **NGJARJE PREZANTUESE PËR DONATORË DHE AMBASADA**

- Organizimi i ngjarjeve me formatin:
  - “Konferenca e Investitoreve – Komuna X”
  - Prezantimi i portofolit të projekteve me dokumentacion të plotë (DAP, fizibilitet, buxhet)
  - Ekspozitë digjitale për vizitorët institucionalë me stenda tematike
  - Ftesa për përfaqësuesit e odave ekonomike, USAID, GIZ, UNDP, ambasadat, etj.

#### **KRIJIMI I NJË PAKETE PËR PREZANTIM INSTITUCIONAL (PITCH PACK)**

- Përfshin: përshkrim të komunës, investimet aktuale, projektet në pritje, profilin ekonomik dhe formate standarde të bashkëpunimit.

### 3.4.PARTNERITETE ME QYTETE DHE SHTETE

#### **BINJAKËZIME ME QYTETE EVROPIANE**

- Zhvillimi i marrëveshjeve për bashkëpunim dhe binjakëzim për:
  - Shkëmbim teknik dhe administrativ
  - Zbatim të projekteve të përbashkëta në kuadër të programit EuropeAid
  - Pjesëmarrje në programet URBACT, Interreg, Horizon Europe, etj.

#### **VIZITA TË ORGANIZUARA ME DELEGACIONE ZYRTARE**

- Përfshirja e delegacioneve të përbëra nga:
  - Kryetari i komunës, përfaqësues nga Kuvendi Komunal
  - Drejtoritë relevante dhe OSHC-të partnere
- Objektivat e vizitave:
  - Prezantimi i potencialit zhvillimor të komunës
  - Identifikimi i bashkëpunimeve për turizëm, edukim, kulturë dhe digjitalizim

#### **PROMOVIMI NDËRKOMBËTAR I KOMUNËS**

- Platformë në uebfaqen komunale në gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht)
- Video promovionale për investitorët e huaj
- Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare me material promovues dhe staf të trajnuar

Veprim	Pëshkrimi	Afati	Aktorët
Platformë digjitale për kalendarin e komunës	Publikim i ngjarjeve, forumeve, takimeve dhe pjesëmarrjeve në nivel kombëtar/rajonl	3 muaj	Komuna, Zhvillim Ekonomik
Udhëzues për organizimin e ngjarjeve komunale	Manual për planifikimin, menaxhimin dhe komunikimin e ngjarjeve me publikun dhe partnerët	6 muaj	Drejtoria për Kulturë, MAPL
Regjistër i partneriteteve ndërkombëtare	Dokumentim dhe ndjekje e marrëveshjeve me qytete binjake dhe organizata ndërkombëtare	Në vazhdim	Komuna, Donatorët
Pako prezantuese digjitale për investitorët	Material i gatshëm për t'u dërguar ambasadave dhe investitorëve të huaj	3 muaj	Zyra për Investime dhe Partneritete



## **SHTYLLA 4: ASPEKTET TEKNIKE TË OUTREACH**

### **4.1. DOKUMENTET PREZANTUESE DHE MATERIALET VIZUALE**

#### **BROSHURA TË INVESTIMEVE DHE PORTOFOL PROJEKTESH**

- Krijimi i broshurave të dizajnuara profesionalisht, në gjuhë shqipe dhe angleze, që përfshijnë:
  - Profilin ekonomik të komunës
  - Lista e projekteve prioritare me përshkrim, kosto dhe afat
  - Informacione për klimën e biznesit dhe benefitet për investitorë

#### **VIDEO PROMOVUESE DHE STORYTELLING LOKAL**

- Prodhimi i videove 3D ose animacioneve që ilustrojnë projektet zhvillimore
- Përfshirja e tregimeve reale nga komuniteti: gra sipërmarrëse, fermerë, të rinj që kanë përfituar nga investimet
- Përdorimi i storytelling lokal për të theksuar ndikimin social dhe ekonomik të projekteve

#### **BRENDIMI I QYTETIT DHE MATERIALET SIMBOLIKE**

- Krijimi i një identiteti vizual zyrtar të komunës që përfshin:
  - Logo zyrtare
  - Moto të komunikimit institucional (“Investo këtu”, “Qyteti i mundësive”, etj.)
  - Ngjyrat standarde institucionale për materiale grafike
- Prodhimi i dhuratave simbolike për investitorë dhe mysafirë:
  - Çanta promociionale, suvenirë lokale, broshura në paketim të personalizuar

## 4.2.PËRGATITJA E FTESAVE, AGJENDAVE DHE MATERIALEVE ZYRTARE



### **TEMPLATE TË UNIFIKUARA PËR KOMUNIKIM ZYRTAR**

Hartimi i formateve standarde për:

- Ftesa fizike dhe digjitale me dizajn të unifikuar
- Email-e zyrtare për ngjarje, takime, prezantime me përmbajtje të standardizuar
- Format të agjendës ditore të ngjarjeve, në formate editable dhe print-ready



### **FORMAT PREZANTIMI TË SHKURTËR DHE TË DETAJUAR PËR PROJEKTET**

- Dokumentacion i përgatitur në dy nivele:
  - Projekt-fiche (1 faqe): përmbledhje e shpejtë për investitorët dhe donatorët (titulli, buxheti, përfituesit, impakti)
  - Dosja e plotë e projektit: përfshin analizë të fizibilitetit, dokumentacion teknik, buxhet të detajuar, indikatorë monitorimi
- Mundësia për përgatitjen e pakove të personalizuara për sektorë të ndryshëm (bujqësi, turizëm, TIK, etj.)



### **MANUAL PËR PROTOKOLLIN E KOMUNIKIMIT ZYRTAR**

- Udhëzues për përdorimin e toneve formale në komunikim
- Standardizim i firmave të email-it, përmbajtjes së shtojcave, dhe formës së adresimit në komunikime ndërkombëtare

## 4.3. PAJISJET TEKNIKE DHE LOGJISTIKA

### **PAJISJE PËR NGJARJE INTERAKTIVE DHE PËRKTHIM SIMULTAN**

Sigurimi dhe përdorimi i:

- Mikrofonëve pa tela dhe audio system me ndarje të kanalit për përkthim simultan
- Projektorë HD dhe panele të zgjuara për prezantime dinamike
- Ekrame LED për evente më të mëdha me pjesëmarrje të gjerë


### **SOFTUER DHE PLATFORMA PËR MENAXHIM TË EVENTEVE**

Përdorimi i aplikacioneve online për regjistrim dhe raportim të pjesëmarrjes si:

- Google Forms për mbledhje të të dhënave të pjesëmarrësve
- Eventbrite për menaxhimin e regjistrimit në ngjarje dhe dërgimin automatik të ftesave
- Canva Pro / PowerPoint për dizajn të agjendave, postera dhe rrjete sociale

### **RAPORTIM PAS NGJARJES DHE NDJEKJE**

- Përgatitja e një raporti pas eventit me të dhëna mbi pjesëmarrjen, reagimet dhe komentet
- Krijimi i një formulari vlerësimi të ngjarjes për përmirësim të vazhdueshëm
- Vendosja e galerisë vizuale dhe videove të eventeve në faqen zyrtare dhe rrjete sociale



Veprim	Përshkrimi	Afati	Aktorët
Udhëzues për përgatitjen e materialeve zyrtare	Manual me formatet standarde dhe shembuj për fresa, agjenda, email-e	3 muaj	Komuna, OSHC
Set multimedial për promovim	Paketë me broshura, video dhe materiale vizuale për evente dhe investitorë	6 muaj	Zyra për Investime
Inventar i pajisjeve teknike për evente	Regjister i logjistikës dhe mjeteve në dispozicion për organizimin e ngjarjeve	1 muaj	Drejtoria për Administratë
Krijimi i "Brand Book" të Komunës	Dokument për brendimin zyrtar të qytetit me rregulla për përdorim grafik	6 muaj	Komuna, dizajnerë lokalë

# 5

## SHTYLLA 5: PËRGATITJA E PROJEKTEVE ZHVILLIMORE

### 5.1. HARTIMI I PROJEKTEVE ZHVILLIMORE

#### DRAFTIMI TEKNIK I PROJEKTIT

- Përgatitja e projekteve sipas strukturës së standardizuar, përfshirë:
  - **Logjika e ndërhyrjes** (problem - qëllim - rezultat - aktivitet)
  - **Objektiva SMART**: Specifik, të Matshëm, të Arritshëm, Realistë dhe të Kohëzuar
  - **Indikatorë të matshëm** për rezultatet, impaktin dhe qëndrueshmërinë
  - Plan pune me aktivitete të detajuara dhe afate kohore të zbatimit


#### ANALIZA E KOSTOS DHE PËRFITIMIT (CBA)

- Aplikimi i modelit të vlerës së përfitimit neto (NPV) dhe koeficientit të kthimit të investimit (ROI) për:
  - Projekte infrastrukturore (rrugë, kanalizime, impiante)
  - Projekte sociale (shkolla, qendra rinore, qendra shëndetësore)
- Analiza e ndikimit të projektit në zhvillim ekonomik dhe përfituesit direkt/indirekt
- Argument teknik dhe financiar për financuesin (donator, qeveri, investitor privat)

#### TEMPLATE I PROJEKTIT TË GATSHËM PËR APLIKIM

- Përfshin: përmbledhje ekzekutive, tabelën e logjikës së ndërhyrjes, buxhetin, matjen e riskut, strategjinë e monitorimit

## 5.2. PRIORITIZIMI DHE HARTËZIMI I PROJEKTEVE



### **LISTA E PROJEKTEVE TË GATSHME PËR FINANÇIM**

Krijimi i një Portofoli Zhvillimor Komunal me projekte të kategorizuara sipas:

- Sektorëve (energji, TIK, bujqësi, turizëm, arsim, shëndetësi)
- Statusit të gatishmërisë (ide, fizibilitet, të gatshme për aplikim)
- Burimit potencial të financimit (IPA III, MZHR, BE, privat)



### **HARTË DIGJITALE E PROJEKTEVE**

Prezantimi i projekteve në format interaktiv me GIS/Web:

- Vendndodhja gjeografike e projektit
- Statusi aktual (në hartim, në zbatim, i përfunduar)
- Shuma e kërkuar, kohëzgjatja, përfituesit
- Përdorim i platformave si Google MyMaps, ArcGIS Online ose Leaflet për publikim në uebfaqen komunale



### **MEKANIZËM PËR PRIORITIZIM OBJEKTIV**

Përdorimi i matricës së përzgjedhjes me kritere si:

- Urgjenca e nevojës
- Numri i përfituesve
- Përputhshmëria me strategjitë zhvillimore
- Potenciali për bashkëfinancim
- Krijimi i një komisioni ndërdrejtorial për vlerësim të projekteve

### 5.3. PËRGATITJA E QASJES NDAJ PALËVE

#### **PAKO INFORMUESE PËR DONATORË DHE INVESTITORË**

Përgatitja e dokumentacionit në formate të standardizuara për donatorë institucionalë: BE, GIZ, SIDA, USAID, Banka Botërore

Investitorë privatë: investime në tokë, infrastrukturë, park industrial

- Pakoja përmban:
  - Projekt-fiche + plan investimi
  - Harta dhe skema të vendit të projektit
  - Argumenti social dhe ekonomik
  - Gjuhët: shqip, anglisht, serbisht

#### **PREZANTIME TË PERSONALIZUARA SIPAS PROFILIT TË PARTNERIT**

Përgatitja e powerpoint pitch me dizajn dhe përmbajtje të ndryshme për:

- Fondet e BE-së
- Agjenci zhvillimore ndërkombëtare
- Odat e investimeve dhe konferenca rajonale
- Përdorimi i grafikëve, hartave dhe narrativës së impaktit lokal

#### **REGJISTËR I KONTAKTEVE STRATEGJIKE**

Databazë me:

- Përfaqësues të ministrive përkatëse
- Koordinatorë të projekteve të IPA-s
- Kontaktet e drejtpërdrejta të donatorëve aktivë në Kosovë
- Përfaqësues të diasporës ekonomike
- Investitorë potencialë që kanë shprehur interes

Veprim	Përshkrimi	Afati	Aktorët
Manual i hartimit të projekteve	Udhëzues me hapa teknike për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe logjikës së ndërhyrjes	3 muaj	Komuna, MAPL, OSHC
Krijimi i Portofolit Zhvillimor Komunal	Listë e strukturuar dhe vizuale e të gjitha projekteve të komunës të gatshme për financim	6 muaj	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
Platformë online për projektet	Harta dhe databazë digjitale për promovimin e projekteve në faqen zyrtare	4 muaj	IT & Komunikimi
Pako promovionale për donatorë	Material i gatshëm për dërgim në konferenca dhe takime të nivelit të lartë	2 muaj	Zyra për Partneritete

# 6

## **SHTYLLA 6: ORGANIZIMI I KONFERENCAVE PER INVESTIME**

### 6.1. PAKO PËR KONFERENCË

#### **DOSJE PREZANTUESE FIZIKE DHE DIGJITALE**

- Përgatitja e pakove të konferencës për investitorët dhe partnerët institucionalë:
  - Broshura me përshkrim të komunës dhe projektet prioritare
  - Statistika të fundit për ekonominë lokale (punësimi, bizneset, tregu i fuqisë punëtore)
  - Case studies të projekteve të suksesshme dhe partneriteteve të mëparshme

#### **PREZANTIME DIGJITALE DHE KODE QR**

- Për çdo projekt të prezantuar, përgatiten:
  - Poster informativ me QR Code që çon në dokumentin teknik të projektit
  - Prezantime PowerPoint me infografika dhe elemente interaktive
  - Ueb-linke drejt portofolit të projekteve në faqen zyrtare të komunës

#### **PAKO TË PERSONALIZUARA SIPAS PROFILIT TË PJESËMARRËSVE**

- Paketat ndahen sipas interesit të investitorëve: TIK, bujqësi, turizëm, energji, etj.
- Materialet ofrohen në shqip, anglisht dhe gjuhë të tretë në varësi të publikut (serbisht, gjermanisht, etj.)

## 6.2. PËRGATITJET TEKNIKE DHE LOGJISTIKE

### **LOKACION I PËRSHTATSHËM PËR NIVELIN E NGJARJES**

Përzgjedhje e hapësirës me:

- Salla plenare për prezantime kryesore
- Zona për takime B2B (Business-to-Business) individuale
- Pajisje për interpretim simultan dhe kabina për përkthyes
- Pajisje teknike: mikrofonë pa tela, ekran LED, sistem audio-profesional
- Hapësirë për media dhe intervista

---

### **PLATFORMA PËR REGJISTRIM DHE MENAXHIM TË PJESËMARRJES**

Aktivizimi i platformës “Komuna për Investitorin” me:

- Regjistrim online të pjesëmarrësve
- Kalendar të sesioneve dhe detaje për agjendën
- Mundësi për përzgjedhje të takimeve me zyrtarët komunalë dhe sektorialë
- Alternativisht, përdorimi i Eventbrite, Google Forms apo Whova

---

### **SISTEMI I ORIENTIMIT NË VEND**

Vendosje e tabelave udhëzuese, hartave të vendndodhjes së zonave të takimeve

Regjistrim elektronik i pjesëmarrjes në hyrje për statistika pas eventit



## 6.3. PROGRAMI I EVENTIT



### **SESIONE PLENARE**

- Hapja nga Kryetari i Komunës, prezantim i misionit dhe përshëndetjet zyrtare
- Fjalime nga partnerë të rëndësishëm: MAPL, MZHR, BE, donatorë ndërkombëtarë
- Prezantim i projektit më përfaqësues si model zhvillimi




### **TAKIME B2B DHE MATCHMAKING**

- Zonë e dedikuar për takime të shkurtra 15-minutëshe me:
  - Investitorë dhe biznese potenciale
  - Diasporën e suksesshme dhe partnerë ndërkombëtarë
  - Institucione financiare dhe agjenci implementuese



### **SEKTORIALIZIMI I PREZANTIMEVE**

- Sesione të veçanta për prezantimin e potencialit të:
  - TIK-ut dhe startup-ve
  - Bujqësisë dhe industrisë përpunuese
  - Turizmit dhe trashëgimisë kulturore
  - Energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencës energjetike
- Përfshirja e sesioneve pyetje-përgjigje për transparencë dhe dialog





## 6.4. KONCEPTI DHE REZULTATET E PRITURA


### QËLLIMI I NGJARJES

- Të promovojë projektet e gatshme të komunës
- Të sigurojë mbështetjen e parë nga investitorë dhe partnerë zhvillimorë
- Të nxisë bashkëpunime publike-private dhe ndërdrejtorake

### REZULTATET E MATSHME

- Numri i kontakteve B2B të realizuara gjatë konferencës
- Numri i **pakove informuese të shpërndara** dhe dokumenteve të shkarkuara përmes QR
- Numri i **memorandumeve të interesit** të nënshkuara (Letter of Intent)
- Interesimi i shprehur për financim dhe projektet që futen në fazën e negociatave
- Ndjekja (follow-up) me partnerët potencialë pas eventit brenda 30 ditësh

### RAPORT I DETAJUAR PAS EVENTIT

- Raport mbi pjesëmarrjen, aktivitetet, takimet dhe vlerësimet nga pjesëmarrësit
  - Plan i ndjekjes dhe kontaktimit për çdo partner të interesuar
  - Përfshirje në planin e komunikimit dhe projektet në vijim
- 

Veprim	Përshkrimi	Afati	Aktorët
Modeli i Konferencës Komunale për Investime	Udhëzues standard me program, fresa, format prezantimi, dhe organizim teknik	3 muaj	Komuna, MAPL, GIZ
Pako digjitale për konferencë	Broshura, video, projekte me QR Code, të gatshme për shpërndarje	2 muaj	Zyra për Investime
Platformë për menaxhim të pjesëmarrjes	Web mini-portal për regjistrim, matchmaking dhe feedback	1 muaj	IT / Komunikim
Kalendrar vjetor i forumeve investuese	Ngjarje rajonale dhe tematike me pjesëmarrje të komunës	Në vazhdim	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

# 7

## SHTYLLA 7: FOLLOW-UP PAS EVENTEVE

### 7.1. RISHIKIMI I DOKUMENTEVE DHE KONSOLIDIMI I KOMENTEVE

#### **PËRDITËSIMI I PROJEKT-FICHE-VE DHE DOKUMENTEVE SHOQËRUESE**

Pas feedback-ut të marrë gjatë konferencës, secili projekt përditësohet me:

- Sugjerimet dhe komentet teknike të investitorëve dhe donatorëve
- Qartësimi i indikatorëve, planit të veprimit, impaktit të pritshëm dhe buxhetit
- Referenca ligjore dhe plane për menaxhimin e rreziqeve

#### **KRIJIMI I VERSIONEVE PËRFUNDIMTARE PËR APLIKIM**

Dokumentet përfundimtare ndahen sipas natyrës së aplikimit:

- Projekte për financim të drejtpërdrejtë
- Projekte për bashkëfinancim me aktorë qendrorë
- Projekte për partneritet publik-privat (PPP)
- Aplikimi për çdo projekt përgatitet në formatin standard të donatorit/institucionit pritës

#### **PLATFORMË DIGJITALE PËR KONSOLIDIM KOMENTESH**

Përdorimi i formave si Google Sheets, Trello ose sistemet CRM për ndjekje të komenteve dhe gjendjes së çdo aplikimi

## 7.2. APLIKIMET E DETAJUARA



### **PËRGATITJA E APLIKIMEVE NË PLATFORMA FINANCUESE NDËRKOMBËTARE**

- Draftimi dhe dërgimi i aplikimeve në këto platforma:
  - [EU Funding & Tenders Portal](#)
  - Western Balkans Investment Framework (WBIF)
  - Programet e USAID, GIZ, UNDP, SIDA, SNV, etj.
- Strukturimi i aplikimeve në bashkëpunim me partnerët teknikë dhe drejtoritë relevante



### **MBËSHTETJE JURIDIKE DHE FINANCIARE NGA NIVELI QENDROR**

- Koordinim me MAPL dhe MZHR për:
  - Sigurimin e bashkëfinancimit në aplikime ndërkombëtare
  - Harmonizim me politikat kombëtare dhe dokumentet strategjike
  - Përdorimin e klauzolave standarde të bashkë-aplikimit në partneritetet me komunitat e tjera



### **KRIJIMI I NJË NJËSI TË BRENDSHME PËR APLIKIME DHE PROJEKT-MENAXHIM**

- Funkcionalizimi i një "Task Force" për menaxhimin e aplikimeve ndërkombëtare
- Trajtime për përdorimin e platformave të aplikimit dhe raportimit

### 7.3. NDËRMARRJA E NISMAVE TË REJA PAS EVENTEVE

#### **NISMA KOMUNALE TË PAS-KONFERENCËS**

- Aktivizimi i iniciativave konkrete zhvillimore të frymëzuara nga eventet:
  - Shoqata ekonomike lokale: rrjete të biznesit lokal për promovim dhe bashkëpunim
  - Qendra inkubimi për ndërmarrësi: me fokus të rinjtë, gratë, të kthyerit nga diaspora
  - Programet pilot për testimin e modeleve të zhvillimit lokal (tregje prodhuesish, energji alternative, teknologji për arsimin)

#### **RAPORT TREMUJOR PËR PROGRESIN E PROJEKTEVE**

- Përgatitja e raportit të progresit për çdo tremujor, që përfshin:
  - Gjendjen e secilit projekt të prezantuar
  - Komunikimet me partnerët/investitorët e interesuar
  - Aplikimet e dorëzuara dhe statusin e tyre
  - Rekomandime për veprimet e ardhshme
- Publikimi i raportit në uebfaqe dhe shpërndarja në rrjetin e partnerëve

#### **FOLLOW-UP I DREJTPËRDREJTË ME KONTAKTET E NGJARJEVE**

- Aktivizimi i formularëve të ndjekjes për kontaktim të të gjithë pjesëmarrësve
- Dërgimi i përmbledhjeve, prezantimeve dhe paketave të rifreskuara
- Planifikimi i takimeve bilaterale (online ose fizike) për thellim bashkëpunimi



Veprim	Përshkrimi	Afati	Aktorët
Krijimi i Planit të Follow-Up	Model me hapa të qartë për komunitet për ndjekjen pas konferencave	1 muaj	Komuna, MAPL
Raporti për progresin e projekteve	Format standard për raportim tërëgjyeshëm të progresit dhe kontakteve	Çdo 3 muaj	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
Trajnime për aplikime ndërkombëtare	Sesione për përdorimin e platformave si WBIF, EU Portal, USAID FormBuilder	2 muaj	Komuna, OSHC, donatorët
Nisma të mbështetura pas-konferencës	Hartimi dhe implementimi i 2-3 nismave pilot komunale me fonde të vogla	6 muaj	Komuna, Bizneset, Diaspora



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
RAJONAL



KOSOVO LOCAL  
GOVERNMENT  
INSTITUTE